

KONTRATË
SHITJE KUOTASH

Sot më datë **09.01.2025**, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nënshkruhet kjo “kontratë për shitje kuotash” si më poshtë vijon:

DISPOZITA PARAPRAKE:

- a. Shoqëria “EB COMMUNICATION” sh.p.k. me NUIS M47412002D, është një shoqëri e rregjistruar në regjistrin tregtar në 12.12.2024, me seli qendrore në adresën: Nr. Pasurie 4/408, zona kadastrale 8593 volumi 20 faqe 130, Shkodër, Shqipëri dhe ka ortak z. Erjon Hoti dhe z. Melidion Dervishi;
- b. Shoqëria “EB COMMUNICATION” sh.p.k. ka si objekt kryesor aktiviteti Hartimin e planeve të personalizuara për promovimin e produkteve apo shërbimeve.; Planifikimin dhe zbatimin e reklamave në platforma të ndryshme, si media sociale, TV, apo revista; Përgatitjen e materialeve vizuale dhe tekstuale si video, foto, postime, dhe artikuj; Përmirësimin e faqeve web për të arritur renditje më të lartë në kërkimet online; Krijimin dhe monitorimin e profileve të klientëve në platformat si Facebook, Instagram, LinkedIn, etj.; Dërgimin e fushatave të personalizuara për klientët ekzistues dhe potencialë; Studimin e sjelljes së konsumatorëve dhe trendëve të tregut; Krijimin e identitetit vizual të një marke, duke përfshirë logo, broshura, dhe materiale të tjera promovuese; Xhirimin dhe redaktimin e videove promocionale apo reklamave; Bashkëpunimin me influencues për promovimin e produkteve apo shërbimeve; Menaxhimin e fushatave të sponsorizuara në Google Ads, Facebook Ads, dhe platforma të tjera;Të gjitha veprimtaritë e tjera të lejuara ligjërisht në Republikën e Shqipërisë.;
- c. Secili nga ortakët në shoqëri, përkatësisht z. Erjon HOTI, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04/05/1991 banues në Tiranë, identifikuar me Nr. Personal J10504119P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, është pjesëmarrës në shoqëri me 20%, si dhe z. Melidion DERVISHI, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30/07/1994 banues në Shkodër, identifikuar me Nr. Personal J40730081S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, është



pjesëmarrës në shoqëri me 80%. Kuotat që disponojnë në shoqëri z. Erjon Hoti dhe z. Melidion Dervishi janë objekt i shitjes referuar kësaj kontrate;

- d. Shoqëria “EB Investment”sh.p.k. me NUIS M31324009L, është një shoqëri e rregjistruar ne regjistrin tregtar në 09.01.2023, me seli qëndrore në adresën: Rruga Ismail Qemali, Hyrja nr.2, Pallati 7/1, Tiranë, Shqipëri dhe ka ortak të vetëm znj. Erinda Xhaferraj;
- e. Ortaku i vetëm në shoqëri, znj. Erinda Xhaferraj, i ditëlindjes 16.06.1989, lindur në Corovodë dhe banues në Tiranë madhor dhe me zotësi të plota për të vepruar, mbajtës i ID 035577557 me nr. Personal I95616062W, është pjesëmarrës në shoqëri me 100% të kapitalit.
- f. Shoqëria “EB Investment” sh.p.k dëshiron të blejë kuotat që zotëron z. Erjon Hoti dhe z. Melidion Dervishi në shoqërinë “EB COMMUNICATION” sh.p.k..

Për sa më sipër, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë për shitje kuotash si vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese

- 1) Z. Erjon HOTI, i datëlindjes 04/05/1991 lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me Nr. Personal J10504119P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Z. Melidion DERVISHI, i datëlindjes 30/07/1994 lindur dhe banues në Shkodër, identifikuar me Nr. Personal J40730081S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nga këtu e më poshtë referuar si “**Shitësi**”,

dhe

- 2) Shoqëria “**EB Invesmtent**”sh.p.k. me NUIS M31324009L nga këtu e më poshtë referuar si “**Blerësi**”.

Neni 2

Objekti i kontratës



2.1. Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit kundrejt Blerësit të kuotave të zotëruara nga Shitësi, e cila përfaqëson **100% (njëqind përqind)** të kapitalit dhe veprimtarisë së shoqërisë “EB COMMUNICATION”sh.p.k. (NUIS M47412002D).

2.2. Konkretisht, në përputhje me këtë kontratë, z. Erjon Hoti, shet kundrejt Blerësit, kuotën e zotëruar prej tij në shoqëri, e cila përfaqëson 20% të kapitalit, dhe z. Melidion Dervishi, shet kundrejt Blerësit, kuotën e zotëruar prej tij në shoqëri, e cila përfaqëson 80% të kapitalit.

Neni 3

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes që do t’i paguhet Shitësit nga Blerësi, është 10,000 **lekë (dhjetë mijë lekë)**, vlerë e cila do të likujdohet në përputhje me kushtet e kontratës. Ky çmim është i njëjtë me vlerën e kapitalit aksionar.

Neni 4

Mënyra e pagesës dhe kalimi i pronësisë

4.1. Çmimi i shitjes i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, do të likujdohet nëpërmjet pagesave nga kanalet bankare deri në 180 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitjes. Shitësi me nënshkrimin e kësaj kontrate deklaron se nuk ka asnjë kundështim apo kërkesë shtesë në lidhje me vlerën e paguar nga blerësi.

4.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate prej palëve, Blerësi përfiton kuotën e shitësit dhe shndërrohet në pronar me të drejta të plota të një kuote që përfaqëson **100%** të kapitalit të shoqërisë “EB COMMUNICATION”sh.p.k..

Neni 5

Të drejta e detyrime të palëve

5.1. Shitësi garanton se kuota objekt i kësaj kontrate është e transferueshme dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi kuotën.

5.2. Shitësi pranon që çmimi i cituar në nenin 3 të kësaj kontrate, është çmimi i vetëm dhe përfundimtar në lidhje me shitjen e kuotës (kapitalit) që ai kishte në shoqërinë “EB

COMMUNICATION” sh.p.k., dhe se për këtë qëllim nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim vijues të çdo lloj natyre. Në të njëjtën mënyrë shitësi pranon se mënyra e pagimit të çmimit është mënyra e vetme dhe përfundimtare dhe se ai nuk do të ketë asnjë pretendim vijues të çdo natyre në lidhje me këtë.

5.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate, kuotë (kapital) që menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon Blerësit, ashtu sikurse edhe çdo e drejtë apo përfitim tjetër i lidhur me të, përfshirë edhe të drejtën e Blerësit për të përfituar çdo dividend të maturuar, të deklaruar apo aprovuar deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

5.4 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi merr përsipër të gjitha detyrimet që lindin duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

5.6 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, z. Erjon Hoti dhe z. Melidion Dervishi nuk do të jenë më në cilësinë e ortakëve të shoqërisë.

5.7 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, blerësi i jep të drejtën ekskluzive shitësit pa kundërshtim, që ky i fundit të përdorë pa kufizim termin “EB COMMUNICATION” në emrin e shoqërive të tjera tregtare që do të krijojnë dhe ku do të jetë ortak në të ardhmen.

Neni 6

Të ndryshme

6.1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët bien dakord që çdo lloj dividendi i deklaruar, i maturuar apo për t’u paguar gjatë vitit 2025 i takon vetëm dhe ekskluzivisht blerësit, aksionerët aktualë heqin dorë nga çdo pretendim.

6.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët bien dakord që çdo e drejtë apo detyrim i pasqyruar në pasqyrat e fundit financiare të publikuara të shoqërisë, qëndrojnë me blerësin dhe shitësi heq dorë prej tyre.

6.3 Në rast konflikti midis kësaj kontrate dhe marrëveshjeve të veçanta (nëse ka ose do të ketë të tilla) do të prevalojë parashikimi i marrëveshjes së veçantë, e nëse ka konflikt midis marrëveshjeve të veçanta, do të prevalojë rregullimi më i vonë.

6.4. Pavlefshmëria e një a më shumë dispozitave të kësaj kontrate nuk e bën atë të pavlefshme në tërësi. Në një rast të tillë, kur evidentohet se një a më shumë dispozita të kësaj kontrate janë ose

bëhen të pavlefshme, palët do të zëvendësojnë dispozitën/at e pavlefshme me të vlefshme të cilat i afrohen sa më shumë qëllimit të palëve të shprehur përmes dispozitave që janë ose bëhen të pavlefshme.

Neni 7

Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

7.1. Kjo kontratë përgatitet në 3 kopje, të treja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës, ndërkohë që një kopje do ti njoftohet dhe do të aplikohet pranë rregjistrimit tregtar.

7.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

EB Communication

Melidion Dervishi



Erjon Hoti



BLERËSI

EB Investment sh.p.k.

Erinda Xhaferraj

